Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të koston, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar, që mund të jetë kriter me trend zbritës ose me trend rritës.

a) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend zbritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b) Në rastet e vlerësimit të ofertës ekonomike më të favorshme, për kriteret me trend rritës, zbatohet formula si më poshtë:

$$Pk1 = Ok1 \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Opsioni 2) – Oferta Ekonomike më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomike më e favorshme.

21. Konvertimi në valutë të vetme

Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e Kontratës.

22.Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe i ofertës anomalisht të ulët

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- | | |
|--|--|
| 23. Njoftimi i Fituesit | 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese. |
| 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës | <p>1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.</p> <p>2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.</p> <p>Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor; b) garanci bankare; c) garanci nga shoqëri sigurimi. |

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike..

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon vendimin perfundimtar për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ Enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Formulari i Ofertës ekonomike, për procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik

Shtojca 3: Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 4: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 5: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 8: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formular duhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

LOTI 1 – BLERJE DETERGJENT DHE AROMATIZUES

1. Solucion larës dyshemeje (pllakash): me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ -1.1 gr/cm³ . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi në bidon plastik me konfeksione sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

2. Pluhur larës për lavatriçe, për rroba të bardha: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³ . Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Përmbajtja e perboratit të jetë jo më pak se 2 %. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike/kuti kartoni, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Aktiv në të gjitha temperaturat dhe me çdo lloj fortësie uji. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

3. Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Pluhur me enzima dhe përbërje të avancuar. Përmban sapun, kripra fosfori dhe elementë zbardhës me bazë oksigjeni që japin efekt dhe në ujë të ftohtë dhe temperatura të ulëta. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³ . Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

4. Pluhur larës për rroba larje me dorë: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³ . Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë të jetë jo më pak se 95% . Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e madhe se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

5. Solucion larës xhamash: me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³ . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.

6. Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Faqe 13 nga 27 Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%.

7. Solucion larës enësh xhel: me efekt pastrimi të thellë të yndyrnave. Ambalazhimi në enë plastike me kapak. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e produktit të jetë xhel (në formë paste). Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6.5 deri në 8. Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 20% deri në 35%.

8. Solucion për pastrim të parketit: Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me arome parfumi. Vlera e PH nga 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë me vlerë minimale jo më pak se 2.4 % dhe me vlerë maksimale jo më shumë se 5.5%.

9. Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash: Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%.

10. Solucion larës për mobilje: me efekt pastrimi të njollave të forta dhe pluhurave tek mobiljet. Pastrues neutral me pak shkumë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe me kokë shisheje me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë parfumi. Të jetë i tretshëm 100% në ujë. Densiteti të jetë nga 0.9 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³ . Vlera e PH të jetë nga 6 deri në 7.5. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 7%.

11. Shampo antiparazitare (pedikulocid): Përmban pyrethrin jo më pak se 0.35%, piperonil butoxide jo më pak se 2%. I ambalazhuar në shishe plastike. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

12. Shampo parazitësh, për larje koke: të ketë aftësi pastruese të zbokthit dhe zbutjes së flokut gjatë larjes. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng i plotë, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH jo më e madhe se 6 dhe jo më e vogël se 5.5. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 15,000 cp dhe jo më i madh se 25,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,025 +/- 0,025 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

13. Shampo për larje koke: të ketë aftësi pastruese të zbokthit dhe zbutjes së flokut gjatë larjes. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH të jetë 6-7. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 15,000 cp dhe jo më i madh se 25,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,025 +/- 0,025 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

14. Shampo për larje trupi: të ketë aftësi pastruese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH të jetë 6-7. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 10,000 cp dhe jo më i madh se 15,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,016 +/- 0,005 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

15. Sapun i lëngshëm: ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 Faqe 14 nga 27 gr/cm³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

16. Detergjent i parfumuar: i përshtatshëm për çdo lloj pëlhure, aktiv në të gjitha llojet e papastërtive. Pa përmbajtje fosfate. Nuk ndryshon ngjyrat. Efektiv në të gjitha fortësitë e ujit.

17. Detergjent kundër yndyrnave: efikas kundër njollave më të forta. Në gjendje të lëngët, kundër yndyrës për të gjitha llojet e rrobave. Efektiv në të gjitha temperaturat e ujit.

18. Detergjent kundër njollave (sgrasatore): largon pluhurin, vajin dhe ndotësit e tjerë. Me veti zbutëse të papastërtive.

19. Sapun rrobash: Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 deri në 1.2 gr/cm³ . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë jo më e madhe se 5 cm.

20. Sapun tualeti duarsh: Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr/cm³ . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë më e vogël se 5 cm.

21. Detergjent pluhur për makinat larëse: për rrobat e bardha dhe me ngjyrë, pluhur i plotë me fuqi pastrimi optimale. Pa përmbajtje fosfate, tepër efikas në temperatura të ndryshme të ujit.

22. Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

23. Acid muriatik: përmbajtje acidi klorhidrik 21%. Zbardhës alkaline. Densiteti 1.1-1.4 gram/cm³.

24. Acid organik pastrues: lëng special për pastrimin e papastërtive kristaline. Lëng transparent, densiteti 1-1.3 kg/l.

25. Acid pastrues kundër smërçit: detergjent antikalkare me përdorim të shumëzueshëm, me shkëlqim. Eliminon mbetjet minerale, ndryshk, sapun dhe yndyrna.

26. Acid natyror laktik: I përshtatshëm për pastrimin dhe dezinfektimin e çdo sipërfaqeje. Prodhuar nga lëndë të para me origjinë bimë. Pa përmbajtje kripëra amoniumi.

27. Solucion kundër yndyrës: të ketë veti të mira pastruese në të gjitha sipërfaqet, të jetë në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e pH të jetë 10 deri në 14. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³ . Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ambalazhimi në shishe plastike.

28. Solucion larës WC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të

fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.

29. Zbardhues rrobash (açe me përmbajtje hipoklorit natriumi 3-4%): Dezinfektant dhe zbardhues cilësor për larjen e rrobave. Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen me aromë të lehtë klori. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Përbërja e klorit tek Faqe 15 nga 27 solucionit duhet të jetë nga 3% deri në 4% klor. Densiteti të jetë nga 1.0 gr/cm³ deri në 1.2 gr/cm³.

30. Solucion për pastrimin e smërçit/kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi: Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

31. Solucion për pastrimin e smërçit /kriprave për lavatriçe: Të jetë masë e pluhurizuar dhe granular për përdorim në lavatriçe. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika në kuti kartoni trajtë pluhuri. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

32. Solucion për zhbllokim lavamani: me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

33. Solucion për zhbllokim banjo (WC/Pileta): me efekt zhbllokimi të shpejtë. Ambalazhimi në shishe plastike në trajtë lëngu, ambalazhuar nga fabrika. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene, të ketë aromë të këndshme. Të mos ketë nevojë për tu holluar, në mënyrë që të mos krijojë spërkatje. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

34. Spray kundër pluhurit: i përshtatshëm për të gjitha sipërfaqet. Parandalon akumulimin e pluhurave, redukton pluhurin në ajër duke e kapur atë në pëlhurë. Fuqi e lartë anti pluhur, me fuqi të lartë absorbuese.

35. Aromatizues zyre: Të jetë me sprucim, i përshtatshëm për ambjente zyre. Neutralizon aromat e ambientit, shpërndan aromë të freskët.

36 Aromatizues ambienti për aparatin: Të jetë statik për tu vendosur në mur në mënyrë të pavarur. Të jetë me aromë të këndshme.

37. Aromatik tualeti: me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues në formë sapuni të cilat vendosen brenda në kasetën e tualetit ose brenda në anën e WC-së.

LOTI II BLERJE DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIM DHE DERATIZIM

1. Insekticid për bletë/miza/milingona: Insekticid për ambiente të brendshme. Të jetë me aromë jo shumë të fortë. Të jetë produkt i biodegradueshëm.

2. Malathion-Insekticid organofosfat (fosfor organik): I përdorshëm për ambiente të jashtme.

3. Rodenticid: Deratizues antikoagulant i gjeneratës së dytë. Të jenë efektive ndaj brejtësve që janë rezistentë ndaj antikoagulantëve të gjeneratës së parë. Të përdoret për zhdukjen e brejtësve në shtëpi, objekte publike, objekte industriale, ferma të shtazëve dhe në fusha.

4. K-othrine (ose ekuivalent): Insekticid për të vënë nën kontroll insekte të cilat janë transmetues sëmundjesh në ambiente të brendshme. Të jetë në formë pluhuri me përqendrim të lartë të piretroidit sintetik.

5. Solucion mizash dhe mushkonjash: Spray me ambalazhim në paketim plastik. Të jetë me aromë jo shumë të fortë.

43. Krem antibakterial: Antiseptik me veti dezinfektuese. Eleminon deri në 99.99% të baktereve. Nuk e than lëkurën.

44. Xhel dezinfektues për duart: Dezinfektues për duar me përmbajtje alkooli 70%. Jo irritues për lëkurën. Faqe 16 nga 27

45. Alkool etilik 70%: antiseptik dhe dezinfektant i përshtatshëm për përdorim të jashtëm, me spektër të gjerë veprimi kundër baktereve, viruseve, majave/kërpudhave. Përdoret për dezinfektim të objekteve të ndryshme, mobilje, pajisje elektroshtëpiake etj.

46. Maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP3: me ose pa valvul, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, të puthitet lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 95\%$, hipoalergjike, pa fibra qelqi, të jetë rezistente ndaj agentëve biologjikë, aerosoleve, yndyrave, ujit, etj. Të plotësojë kërkesat e standardit europian EN 149: 2001 + A1: 2009 ose standardit amerikan NIOSH 95 ose ekuivalent. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.

47. Maskë respiratore me nivel mbrojtës FFP2 (N95): me ose pa valvul, me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, të puthitet lehtësisht me fytyrën dhe hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 95\%$, hipoalergjike, pa fibra qelqi, të jetë rezistente ndaj agentëve biologjikë, aerosoleve, yndyrave, ujit, etj. Të plotësojë kërkesat e standardit europian EN 149: 2001 + A1: 2009 ose standardit amerikan NIOSH 95 ose ekuivalent. Të ketë certifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.

48. Maskë kirurgjike e thjeshtë: me një përdorim, me lidhëse pas veshit ose pas kokës, të mbrojnë hundën dhe gojën, me përshtatës për hundën, të mos shkaktojë probleme me frymëmarrjen, të ketë përshkueshmëri të mirë të ajrit, me nivel filtrimi të ajrit $\geq 99\%$, hipoalergjike, me copë të pathurur me 3 shtresa me palosje, celuloze, poliester, fibër, me formë drejtkëndëshe e sheshtë, me nivel të mirë

mbrojtje, me dimensione 90mm x 180mm (± 10 mm). Afati i skadencës të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.

49. Maskë prej pëlhure: që lahet në 60 gradë dhe hekuroset. Materiali, pëlhurë e butë elastike.

LOTI III BLERJE KIMIKATESH

1. **Hipoklorit Natriumi (NaOCl 10-12%):** ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor.
2. **Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%:** Pluhur i bardhë në gri e lehtë me erën karakteristike të klorit, i imët. Përmbajtja e klorit aktiv 30%-40%.
3. **Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%:** Pluhur i bardhë në gri e lehtë me erën karakteristike të klorit, i imët. Përmbajtja e klorit aktiv 60-70%. 54. **Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%:** Pluhur i bardhë në gri e lehtë në trajtë tablete. Përmbajtja e klorit aktiv 90%. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik. Ambalazhimi të jetë i etiketuar dhe të ketë të specifikuar titullin e klorit aktiv.
4. **Hipoklorit Kalciumi me pastërti 100%:** Pluhur i bardhë në gri e lehtë në trajtë tablete. Përmbajtja e klorit aktiv 90%. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik. Ambalazhimi të jetë i etiketuar dhe të ketë të specifikuar titullin e klorit aktiv.

LOTI IV "BLERJE MATERIALE PËR PASTRIM"

1. **Fshesë për larje makine:** të jetë e përbërë me qime të gjata mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme për një bisht të gjatë, të përbërë nga material metalik veshur me një shtesë plastike (shkop standard), gjatësia të jetë jo më e vogël se 100 cm. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e

rrotullimit nga e djathta në montim dhe të ketë kanalin ku lidhet zorra e ujit për të larë makinat. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 335 gr.

2. Fshesë merimangash me shkopi: Fshesa për pastrimin e merimangave, të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Bishti të jetë i gjatë jo më i shkurtër se 100 cm, i përbërë nga materiali metalik i veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim.

3. Fshesë pastrimi pa bisht: Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.

4. Fshesë pastrimi për ambientet e jashtme (industriale): Fshesa të jetë e përbërë me fije të gjata mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Fshesa të jetë me bazament plastik me gjatësi 26 cm +/- 2 cm marzh gabimi, gjerësi 4 cm +/- 2 cm marzh gabimi. Bishti të jetë i përbërë nga material metalik veshur me një shtesë plastike jo më i shkurtër se 25 cm.

5. Fshesë me sfungjer dhe gomë për pastrimin e xhamave: Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham. Shkopi që përdoret për të mbajtur fshesën me sfungjer të jetë jo më i vogël se 25 cm dhe pesha e gjithë fshesës me sfungjer të jetë jo më e vogël se 216 gr.

6. Fshesë për pastrim territori, melakuqi: Fshesa të jetë për pastrimin e territoreve të jashtme, e përbërë nga fije melakuqi të dendura dhe të kapura fortë me njëra tjetrën. Gjatësia e fijeve të fshesës të jetë mbi 40 cm. Shkopi fshesës të jetë me gjatësi mbi 1 metër.

7. Fshesë Gome me bisht: Fshesa gome me bisht për pastrimin e ambienteve të brendshme, largimin e ujrave, materiali prej gome, me gjatësinë e gomës 40 cm me bisht +/- 2 cm marzh gabimi, me gjatësi 120 cm +/- 2 cm marzh gabimi. Bishti të jetë metalik ose dru me veshje plastike që ti rezistojë ujit dhe përdorimit të përditshëm.

8. Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me fshesë: Të jetë në formë kutie e hapur nga përpara për mbledhjen e papastërtive të ndryshme, e pajisur me një bisht të montueshëm dhe çmontueshëm. Të ketë edhe fshesë me bisht jo më të gjatë se 45 cm.

9. Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik: jo më pak se 70 cm të gjatë. Kacia të ketë gjerësi 21 cm, gjatësi 29 cm, thellësi 10 cm, +/- 2 cm marzh gabimi.

10. Shkopa inoksi: jo më të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë alumini me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.

11. Shtupë për larje dysHEMEJE: përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të Faqe 18 nga 27 jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.

12. Shtupë pambuku për larje dysHEMEJE: përbërë nga fibra tekstili me përbërje mikrofibrë që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.

13. Shtupë profesionale tharëse për dysHEME: shtupa të jetë me fije akrilike me mikrofibër, jo më të vogël se 60 cm. Përdoret për të tharë dysHEMENË pas larjes ose për të fshirë në dysHEMENË të thatë pa ngritur pluhur.

14. Leckë pastrimi pllakash: Të jetë me formë drejtkëndore, e përbërë nga fibra tekstili të buta që thithin ujin shumë mirë, me material mikrofibër. Të ketë aftësi të heq nivelet më të larta të papastërtive. Dendësia e leckës të jetë jo më e vogël se 160 gr. Të ketë qëndrueshmëri, gjatësia e leckës të jetë jo më e vogël se 40 cm.

15. Furçë dhëmbësh: Të ketë fije normale dhe të buta për pastrim më efikas të sipërfaqes së dhëmbëve. Përdoret për pastrimin e baktereve dhe papastërtive nga dhëmbët dhe hapësirat midis dhëmbëve. Ky produkt është i përshtatshëm për përdorim të përditshëm.

16. Furça për lyerje muri me gëlqere: Furça të jetë me bisht druri jo më e gjatë se 10 cm.

17. Furça pastrimi lavamani: Furçë për pastrim efikas dhe higjienik. Bishti të jetë i përshtatshëm me pëllëmbën e dorës, fijet e furçës të jenë të forta për të pastruar sipërfaqet e vështira të lavamanit. Pesha jo më e vogël se 190 gr. Gjatësia e furçës jo më pak se 30 cm.

18. Furça për pastrimin e WC-së: të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.

19. Furça për larje muri me pllaka: me bisht, të jetë e përberë me qime të gjata mbi 10 cm dhe me qime të buta. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit me shkopin. Shkopi me filetimit standard dhe me gjatësi jo më të vogël se 110 cm. Pesha e fshesës të jetë jo më e vogël se 340 gr dhe pesha e bishtit të jetë jo më e vogël se 140 gr.

20. Furça të vogla të ashpra kirurgjikale: të jenë për pastrimin e mjeteve kirurgjikale.

21. Furça të vogla për pastrim të imët: Bishti të jetë i përshtatshëm me pëllëmbën e dorës, fijet e furçës të jenë të forta për të pastruar sipërfaqet e vështira. Forma e furçës të jetë në formë trekëndore, maja e furçës të jetë për pastrimin e vendeve të vështira.

22. Furça rroje: Furçat e rrojës të jenë me fije të dendura dhe me bisht druri ose plastike.

23. Lecka për larje xhamash: Lecka të jetë me material mikrofibër, e përbërë me 80% poliestër dhe 20% poliamid. **24. Kartëpiceta buke:** Të kenë përmasa të ndryshme me material letër, të jenë cilësore dhe rezistente në përdorim. Pesha e pakos min 100 fije, jo më e madhe se 130 gr.

25. Peceta pluhurash të thjeshta: Të jenë të paketuara në qese min 3 fije/pako. Të jenë me shumë se një përdorimëshe. Të kenë veti të mira përthithëse.

26. Mbajtëse për letrat: makineta të instalohet shumë lehtë në sipërfaqe si pllaka, material plastik rezistente. Nxjerrja e letrës të bëhet nga poshtë aparatit.

27. Letër kasete banjo: të jetë cilësore dhe e ambalazhuar në kuti kartoni në përshtatje me mbajtësen e letrës.

28. Letër alumini: e paketuar në kuti. Gjatësia e letrës së aluminit të jetë 10 m dhe të jetë me shkëputje.

29. Letër duarsh: me kuti, fletë palosje zig zag me përberje 100% celuloze. Të jetë e paketuar në kuti ose në qese min 250 fije/pako. Letra të ketë mundësi thithje të lartë. Faqe 19 nga 27

30. Letër kuzhine e paketuar: Letra të jetë e paketuar, standard me rula. Të jetë cilësore. Të jetë 10 m dhe të jetë me shkëputje.

31. Letër higjienike e paketuar: Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, fletëpalosje zig-zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.

32. Letra të lagura higjienike: me aromë natyrale, e përdorshme për higjienën min 100 fije/pako, për bebe dhe të rritur. Të jetë e testuar dermatologjikisht, ti përshtatet pH të lëkurës.

33. Peceta pastrimi mikrofibër: Të jenë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e mobiljeve të ndryshme, me aftësi super thithëse të jenë me ambalazhim min 3 fije/pako.

34. Govatë për bebe: të jetë plastike, cilësore dhe e thellë me gjatësi min 100 cm.

35. Kanistër (kosh) plastik për mbajtje medikamentesh: Të jetë i ndarë në dhomëza për të diferencuar medikamentet. Materiali i fortë plastik me kapak.

36. Kosh grumbullimi për mbetje infektive. Të ketë dy rrota për transportin e tij në pjesën e pasme. Në pjesën e sipërme kapaku të ketë dy doreza për hapjen e tij. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum min 30 Litër.

37. Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave, të jetë në formë drejtkëndore ose rrethore, me kapak nga sipër që hapet si dritare. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum min 5 Litër.

38. Kosh ambienti metalik me kapak, në forma të ndryshme, pjesa e sipërme e koshit të jetë me kapak që hapet me pedal ku të vihen qeset e koshit. Me volum min 5 Litër, material inox.

39. Kosh plastik i madh, të jetë në forma të ndryshme, me kapak nga sipër që hapet plotësisht. Të ketë dy doreza në pjesën anësore me qëllim transportimin e tij. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum minimal 50 Litër.

40. Karrocë për larje dhe shtrydhje me rrota: Të jetë një dhomë dhe me shtrydhje mekanike, të kompletuar me shtupë pambuku dhe shkop plastik jo më të vogël se 110 cm. Korniza e mbajtjes së kovës të jetë plastike, doreza e shtrydhjes të jetë plastike dhe me doreza plastike me volum min 10 Litër.

41. Karrocë për larje dhe shtrydhje me rrota me mekanizëm: me një dhomë dhe me lëvizje mekanike 360 gradë me rrotullim, të kompletuar me shtupë mikrofibër. Shtupa e pajisur me shkop për leckën rrotulluese min 10 Litra.

42. Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë: Të jetë e thellë dhe të ketë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës. Kapaciteti mbajtës i kovës të jetë me volum min 5 Litër.

43. Kovë plastike me shtrydhje: të jetë plastike, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jetë me volum min 10 Litër.

44. Kovë e madhe plehrash me pedale për pavion: me volum min 30 Litër.

45. Legen plastik: në forma të ndryshme, të jetë material plastik. Kapaciteti mbajtës i legenit të jetë me volum min 20 Litër.

46. Enë plastike e vogël me një dorezë (Sapllake): të jetë me shënimin e shkallëzuar të mbushjes me ujë, të ketë dorezë për transportin e tij dhe të ketë një volum max 1 Litër.

-
47. Shtrydhëse për kovë larje: të jetë e përbërë në trup me material plastik të fortë dhe doreza të jetë plastike.
48. Kosha tualeti me pedale: Kapaciteti: të jetë me volum min 3 Litër. Materiali metalik me qëndrueshmëri të lartë, rezistent ndaj ndryshkjes. Hapja dhe mbyllja e tij të realizohet me anë të pedales.
49. Legen i vogël plastik: (me volum min 7 litër), të jetë i manovrueshëm gjatë punës dhe i lehtë në përdorim. Faqe 20 nga 27 50. Qese mbeturinash: Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
